



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16969/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, GJYQTARI Ali Latifi, me pjesmarrjen e sekretarës juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures Teuta Danuza nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 16.paragrafi 1.1. të Ligjit për deklarativin e prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73,74,195, dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet me dt. 30.06.2010, me këtë,

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Teuta Gani Danuza e lindur me 23.02.1980 në Prishtinë ku dhe tani jeton rr “Brigadat Kosovare” nr 22/16, psikologe AKK Prishtinë, e pa martuar, të kryer fakultetin e psikologjis, e gjendjës së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse me dt.22.03.2010, si Zyrtar i Lartë Publik është punësuar në psikologe AKK, dhe nga Agjensioni për antikorrupsion nuk e ka dërguar formularin për deklarimin e pasurisë edhe pse i jan dërguar formularët e Agjencionit për Antikorrupsion, në formë fizike dhe në elektronike.

Me ç,ka ka kryer kundërvajtje nga neni 16.paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, andaj për këtë

G j O B I T E T

Me gjobë në shumë prej 1000 (Njëmijë) Euro, të cilën gjobë kan për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të mere formën e prerë, në dobi të AFQ I Drejtësis në Prishtinë xhir.rjedhëse 1000-4300-70000-518. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njejta do të zavendsohet me denim burgu në kohëzgjatje prej 30 (Tridhjet) ditësh, duke u, a llogaritur nga 15 euro, në ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse në emër të paushllit gjyqësor I pandehuri është I obliguar të paguajnë shumën prej nga 5 euro në afat dhe xhirollogari të njejtë me gjobën.

Pagesa e gjobës dhe paushllit gjyqësor mund bëhet në gjykatën komunale për kundërvajtje në Prishtinë.

Nga një kopje të këtij aktvendimi t,u dërzohet të të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjensia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtror gjykatës kërkesënt nr 01-2305/10 të dt. 08.06.2010, për inicimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtari inicoi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të të pandehurës e cila deklaroi:është e vërtetë se kam pranuar materialin me kohë por nuk e kam plotësuar dhe nuk e kam dërguar, për këtë pendohem sepse nuk kam ditur rëndësin e rastit konkret.

Për vërtetimin e gjendjës faktike gjykata ka marrë në pyetje përfaqësuesit e Agjencionit Kundër Korrupsionit të cilët ofruan dëshmi të mjaftueshme me dt. 30.06.2010, se e pandehura për kunder marrjës së materialit për plotësim dhe informim të organeve kompetente për kontrollimin e pasurisë dhe preardhjes të zyrtarëve të lartë, si dhe dhuratave zyrtare që është përcaktuar në nenin 3 të Këtij ligji të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, e njejta këtë nuk e ka bërë, andaj kërkojmë që gjykata të vepron sipas kërkesës dhe ligjit që është në fuqi.

Me rastin e shqiptimit të denimit, gjyqtari vleroi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit I,u shqiptua ky lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmën t, shmangët kryerjës së veprave të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjës së këtij aktvendimi nëpërmes të kësaj Gjykate pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARI
Mr.Sc. Ali Latifi

